

(EMRI I AUTORITETIT KONTRATKOR)

Datë 22.05.2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Riparim (rindërtim) vepra arti (ura, tombino, etj)” (Kalimi i tubacionit të furnizimit me ujë të lumit Erzen me tubacionin DN700 Celiku)

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pune
ndetimi - 45000000-7**

VLERA E FONDIT LIMIT: 64,567,889 (gjashtëdhjetë e katër milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) leke, **pa TVSH.**

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti/enti kontraktor HSH sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është mbi kufirin e ulët monetarë

Në përputhje me nenin 33 të LPP kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetar:

- 650.000.000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 40.000.000 (dyqind milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Kërkesat e mësipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi mësipërcituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në *Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe merre persiper çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në *Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë*

19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: ” Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është “E Hapur – Punë Publike - Mbi kufirin e ulët monetar – Prokurim publik me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”a” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se 50% e vlerës së kontratës) është brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohet. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në kete procedure eshte gjykuar qe vlera e xhiros se kerkuar te jete minimalisht sa 50% e vleres se parashikuar te kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përkatësisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kërkesa konsiderohet e

përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore“ përcaktohet se : ”Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**".*

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe

vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre
Kjo kërkesë është vendosur me qëllim që AK të ketë mundësinë të shohë nëse OE pjesmarrës kanë apo jo detyrime ndaj NJ.Q.V, fakt që tregon fleksibilitetin e tyre financiar.

❖ Kriteret e kapacitetit teknik të mëposhtme nga pika 2.3.1 deri në pikën 2.4.5, janë hartuar dhe argumentuar nga specialistët e fushës, të cilët janë pjesë përbërse e njësisë së prokurimit të procedurës, duke u administruar në dosjen e procedurës së prokurimit, procesverbali i hartimit dhe argumentimit të kritereve të kapacitetit teknik i nënshkruar , nga to në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në pikën 2 të nenit 74 dhe në pikën 2 të nenit 78 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik e ndryshuar, si dhe njoftimit Nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodat/teknologjinë dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;

- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore perkatese.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatorëve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në mbështetje të Nenit 88, pika 3 e VKM 285/2021, parashikon se: *“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”*

Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”*.

Po ashtu, në rastet e BOE, dokumentacioni i kërkuar për të vertetuar përvojën e mëparshme si kontrata e bashkëpunimit disponohen nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që ka çdo shoqeri në dosjen e saj në rastin kur ka qene në atë status, e për rrjedhojë nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe nuk sjelle asnjë kufizim të pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit në fjale.

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe në fund janë propozuar dhe vendosur nga specialistët e fushës inxhinier, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik e ndryshuar, si dhe njoftimit Nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik”

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:

N.P - 1 B Punime gjurmimi në tokë

N.P - 2 A Ndërtime civile e industriale;

N.P - 7 B Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

N.S – 18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

NP-1 B Punime gjurmimi në tokë

Sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gërmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës, si rezultat i ndërtimit të mikrotunelit të nenkalimit të Lumit Erzen. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gërmimit dhe sistemimit, në paragrafët përkatës. Kategoria B i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P - 2 A Ndërtime civile e industriale.

Me punime të tilla, referuar VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavanëve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti.

Ndërhyrjet objekt kontrate, parashikojnë ndërtimin e ri të pusëtave të reja të kontrollit, të cilat do të ndërtohen si struktura mbajtëse dhe dhoma për vendosjen e saracineskave, filtrave, matesve etj., forcim të gërmimeve nëpërmjet armaturave të tipit trench box, etj.

Në total vlerat për realizimin e ndërtimit të ri dhe kompletimin me strukturat e nevojshme të pusëtave, punime plotësuese dhe pajisje i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë A sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

N.P - 7 B Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti.

Ky objekt parashikon ndërhyrjen në linjen e ujësjellësit, për të bërë nenkalimin e saj poshtë lumit Erzen nëpërmjet mikrotunelit. Nisur nga preventivi dhe natyra e punimeve, kemi të bëjmë me furnizim vendosje pusëta kontrolli, tuba celiku dhe gize, saracineska, fllanxa, reduktor, filtra Y, rakorderi, Matesa Elektromagnetik, etj, punime të cilat janë totalisht punime që i perkasin kategorise NP-7.

Per sa me siper ne total vlerat për realizimin dhe kompletimin me strukturat e nevojshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë B sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

N.S - 14 A *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.*

Me impiante të kësaj tiplogjie, në shtjellim të N.S – 14 *konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Projekti i zbatimit parashikon ndër të tjera zbatimin e punimeve për vendosjen e dy matesve elektromagnetik, te cilet jane te pajisur me sisteme komunikimi SCADA, panele diellore per furnizim me energji elektrike dhe lexim ne distance.

Punime të tilla duhet të realizohen nga subjekte të kualifikuar për realizimine tyre, në përputhje me VKM nr.42 të datës 16.01.2008, më sipër cituar. Licensa e nevojshme për realizimin e këtyre punimeve, referuar këtij akti është N.S - 14 - Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. Kategoria A i referohet vlerës së punimeve të tilla në preventivin e punimeve.

N.S – 18 A *Punime topogjeodezike*

Është kërkuar për arsye të zbatimit të rilevimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 B	Punime gërmimi në tokë	Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi $b > 1$ m, $h=1.5$ m, toke e zak. Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke zak Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi $b > 1$ m, $h=1.5$ m, toke e zak. Mbushje me material te germuar Gërmimi i pusetave për hyrjen e materialeve dhe puseta dalëse e nënkalimit (në prani të ujrave nëntokësore mbi 2 m thellësi, me thellesi gërmimi 6m, me perforcim me palankola tip Omega 8dhe	21-50 mln leke	30,643,248.29

		largim uji me sistemin well point) Shpim horizontal me mikrotunel me drejtim me lazer për vendosjen e tubit prej çeliku DN 914 mm Shpim me metoden HDD për vendosjen e tubit Dn250mm		
N.P - 2 A	Ndërtime civile e industriale.	Perforcim germimi per thellesi deri 3 m (armatura te tipit trench box) Shtrese zhavor lumi t=20cm, me cilindrim Shtresë betoni (shtresë e varfër) C12/15 Mbushje me beton C 20 per inkastrim nga presioni i ujerave nentokesore Puse kontrolli 4x2x2 m Puse kontrolli 2.5x1,5x2 m	0-20 mln leke	2,154,705.96
N.P - 7 B	Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vadtje	F.V. Tub Celiku I hidroizoluar nga jashte me HDPE dhe lyer nga brenda me boje epokside, DN 711mm, t = 16mm Lidhja me tubacionin ekzistues Fllanxhë adaptor me saldim DN 700 mm, Pn 25 bar Pjese Çmontuese DN 700 mm, Pn 25 bar Saracineske fluture me AUM DN 700 mm Pn 25 bar Ti DN 700 x 150 x 700 mm Pn 25 bar Saracineske Dn150 mm Pn25 bar Tub gize me DN 150 mmme fllanxha Pn 25 bar L = 1500 mm Fllanxhë adaptor për tub HDPE DN 150 mm, Pn 25 bar Filter Y DN 150 mm, Pn 16 bar Reduktor Presioni DN150 mm Pn 16 bar Pjese Çmontuese DN 150 mm, Pn 16 bar Saracineske Ti e komporuar Dn150 mm Pn16 bar me 2 akuator elektrik, komandim ne distance me panel diellor Berryl gize DN 150 Pn 16 bar Tub gize me DN 150 mm me fllanxha Pn 16 bar L = 500 mm Fllanxhë adaptor për tub HDPE DN 150 mm, Pn 16 bar	21-50 mln leke	22,569,470.5

		<p>Reduksion EF 150x110 Manikot EE Ø160 Pn16 F.V. Tub Celiku I hidroizoluar nga jashte me HDPE dhe lyer nga brenda me boje epokside, DN 711mm, t = 16mm F.V. Tub çeliku për këmishim të përhershëm të tubacionit të KUN, DN 914 mm, t = 12.5 mm Pastrim i tubit Me uje me presion dhe terheqja me vakum e llumit e tubit prej çeliku DN 914 mm para instalimit të tubit te Celikut Dn 711 mm,. F.V. Brryl celiku 45°-90° DN 700 perfshire hidroizolimimin ne saldime F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=250mm, t = 18.4 mm, PN 10 F.V.Tub PE100RC DN160mm ,Pn25 bar</p>		
N.S - 14 A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.	<p>Mates Elektromagnetik Ø 700 me panel diellor me transmetim ne distance, Pn 25 bar Mates Elektromagnetik Ø 150 me panel diellor me transmetim ne distance, Pn 16 bar</p>	0-20 mln leke	6,125,802.88
N.S-18 A	Punime topogjeodezike	Është kërkuar për arsye të zbatimit të rievimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt.		

2.3.3 Operatori pjesëmarrës duhet te ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këto kritere i ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6.

Keto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.

Lloji i profesionit të inxhinierëve të kërkuar lidhet me natyrën e punimeve sipas zerave të preventivit. Inxhinieri i ndertimit kërkohej për të ndjekur të gjitha proceset e ndertimit të pushtave dhe armaturave mbajtëse si dhe problematikave të tjera që mund të dalin gjatë rrugës me strukturat mbajtëse të paisjeve apo tubacioneve. Inxhinieri Hidroteknik kërkohej për të ndjekur ecurinë e punimeve në teresi, dhe specifikisht të punimeve të tubacioneve, saracineskave dhe rrjetit hidraulik. Inxhinieri Gjeodet është i nevojshëm për të ndjekur punimet e germimit, natyrës së dherave dhe qendrueshmërisë së tyre si dhe mbikqyrjen e përmbajtjes së reagenteve të tjera në dhera që mund të ndikojnë në impelmentimin me sukses të kontratës. Inxhinieri elektrik kërkohej për të ndjekur instalimin e matësve elektromagnetik të cilët janë paisje gjysem elektrike gjysem hidraulike nga parimi i punës. Gjithashtu matësat janë të lidhur me sisteme leximi në distance dhe panele fotovoltaike diellore që kërkojnë patjetër praninë e inxhinierit elektrik gjatë instalimit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues minimumi për muajin e fundit, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licencuar sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

Shënim: Ky kriter (2.3.7) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 3, pika 3, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Ligjin Nr.10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" (i ndryshuar), VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masat e vecanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" (i ndryshuar) i cili përcakton "2/1. Punedhësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndermarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike dhe12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndermarrjes është e detyrueshme për ato ndermarrje,

ku numri i te punesnarve eshte jo me pak se 15 punonjes ... Mjeku i ndermarrjes ofron keshillimin e tij per problemet e mbrojtjes ne pune, per shmangien e aksidenteve dhe te semundjeve profesionale, si dhe per te gjitha ceshtjet e mbrojtjes se shendetit dhe sigurise ne pune. Ai vlereson ceshtje te fiziologjise se punes, te problemeve higjienike e sanitare, vecanerisht te ritmit e te kohes se punes, te organizimit te vendit te punes, te zhvillimit dhe te mjediseve te punes.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.

***Shënim:** Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurise e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion, dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier ". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te realizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar:

- Teknik Ndërtimi 1 (nje)
- Hidraulik 2 (dy)
- Saldator 2(dy)
- Elektracist 2(dy)
- Karpentier 2(dy)
- Muratore & Suvatues 2(dy)

të vertetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

Argumentimi: Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh.

Ne mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), është hartuar dhe natyra dhe numri perkates i stafit teknik të nevojshem për realizimin e kontrates brenda afatit 3 muaj.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) manovrator nga të cilët 2 (dy) eskavatoriste dhe 1 (nje) automakinist.

Për manovratorët deshmite e aftësi profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën për muajin e fundit kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshira në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues

Për shoferin leje drejtimi e vlefshme dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën për muajin e fundit dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshira në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues .

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor

Argumentimi: Kjo kërkesë është minimale në raport me punën e nevojshme. Kujtojmë se sipas nenit 17 të urdhrimit më sipër cituar, për të mundësuar lëvizjen në rrugë dhe për të shmangur aksidentet, mjetet për të cilat bën fjalë neni 8 i kësaj rregulloreje duhet të qarkullojnë në përputhje me përcaktimet e nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndërsa referuar nenit 8, pika 2, të po këtij akti, për lëvizjen apo qarkullimin në rrugë, makineritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nëse janë të pajisura me

rrota pneumatike, duhet të plotësojnë kërkesat e nenit 113 dhe 122 të Kodit Rrugor, kurse drejtuesit e tyre, në varësi të makinerisë, duhet të jenë të pajisur me kategorinë përkatëse të lejedrejtimimit.

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 12-20 Ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes deri 5-10 Ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 Ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
4	Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 5 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
5	Eskavator me goma me peshe mbi 15 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
6	Eskavator me zinxhir me peshe mbi 25 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
7	Fadrom me goma me kove para mbrapa	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
8	Makineri per shpime nentokesore horizontale me lazer, me diameter DN 710- DN1000mm	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
9	Makineri mikrotuneli per shpime horizontale me drejtim te kontrolluar(HDD) me diameter DN160- DN 250	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
10	Palankola metalike	<i>në pronësi ose me qira</i>	50 ton
11	Vibrator palankolash	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
12	Makineri per shtrengim ankerash palonkoje me piston hidraulik	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
13	Vibrator betoni Thellësie	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
14	Matrapik me benzine	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
15	Betoniere kantieri	<i>në pronësi ose me qira</i>	3
16	Depozite 2000-5000 lit	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
17	Pompe zhytесе	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
18	Motopompe uji	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
20	Balane ndricimi	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
21	Makineri per testimе me presion uji	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
22	Aparat elektrofuziv	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
23	Motosaldatrice	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
24	Vibrator ngjeshes	<i>në pronësi ose me qira</i>	1

Mjete mbrojtese		
Kokore	20 cope	Ne pronesi ose me qera
Fikse Zjarri	2 cope	Ne pronesi ose me qera
Tabela Sigurimi Teknik	20 cope	Ne pronesi ose me qera
Jelek	20 cope	Ne pronesi ose me qera
Kuti Ndhme e shpejt	2 cope	Ne pronesi ose me qera

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:- çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin dhe fotot përkatëse;

- Ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale te qirase e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fitues

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Gjithashtu per përcaktimin e numrit te mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Kerkesa per pajisjen me makinerite e mesiperme eshte e nevojshme per arsyet si meposhte:

Nr	Lloji i Makinerive	Sasia	Referencat në vendosjen e kriterit
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 12-20 Ton	1	Ky mjet do te perdoret per transportin e dheut dhe zhavorrit.
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes deri 5-10 Ton	1	Ky mjet do te perdoret per transportin e dheut dhe zhavorrit.

3	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 Ton	1	Ky mjet do te perdoret per levizjen e dherave apo materialeve inerte brenda per brenda kantierit.
4	Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 5 ton	1	Ky mjet do te perdoret per transportin/levizjen e materialeve brenda kantierit.
5	Eskavator me goma me peshe mbi 15 ton	1	Ky mjet do te perdoret per germime/ sistemime dheu/inertesh.
6	Eskavator me zinxhir me peshe mbi 25 ton	1	Ky mjet do te perdoret per germime/ sistemime dheu/inertesh.
7	Fadrom me goma me kove para mbrapa	1	Ky mjet do te perdoret per germime/ sistemime dheu/inertesh.
8	Makineri per shpime nentokesore horizontale me lazer, me diameter DN 710- DN1000mm	1	Ky mjet do te perdoret per shpimin e mikrotunelit per kalimin e tubacionit.
9	Makineri mikrotuneli per shpime horizontale me drejtim te kontrolluar(HDD) me diameter DN160-DN 250	1	Ky mjet do te perdoret per shpimin e mikrotunelit per kalimin e tubacionit.
10	Palankola metalike	50 ton	Palankolat do te perdoren per te mbajtur dheun/ujrat derisa te ndertohen pusetat/strukturat mbajtese.
11	Vibrator palankolash	1	Do te perdoret per nguljen e palankolave.
12	Makineri per shtrengim ankerash palonkoje me piston hidraulik	1	Do te perdoret per shtrengimin e palankolave.
13	Vibrator betoni Thellësie	1	Kjo paisje do te perdoret per homogjenizimin e betonit dhe largimin e fluskave te ajrit nga betoni per te siguruar nje cilesi me te mire te ndertimit te pusetve dhe strukturave mbajtese.
14	Matrapik me benzine	1	Kjo paisje do te perdoret ne rast nevoje gjate germimeve.
15	Betoniere kantieri	3	Kjo paisje do te perdoret per perzierjen e betonit.
16	Depozite 2000-5000 lit	2	Keto paisje do te perdoren per depozitimin e ujit te nevojshem ne kantier.
17	Pompe zhytese	1	Kjo paisje do te perdoret per largimin e ujit gjate germimeve.
18	Motopompe uji	2	Kjo paisje do te perdoret per largimin e ujit gjate germimeve, ne mungese te elektricitetit.
20	Balone ndricimi	1	Kjo paisje do te perdoret gjate punimeve te tejzgjatura ne rast se do kete, ose ne raste emergjencash.
21	Makineri per testime me presion uji	1	Kjo pajisje eshte nevojshme per realizimin e punimeve hidraulike. Disponimi i të një pajisjeje të tillë lidhet drejtpërdrejtë me zbatimin cilësor të këtyre punimeve.
22	Aparat elektrofuziv	1	Kjo pajisje eshte nevojshme per

			realizimin e punimeve hidraulike. Disponimi i të një pajisjeje të tillë lidhet drejtpërdrejtë me zbatimin cilësor të këtyre punimeve.
23	Motosaldatrice	1	Kjo paisje do te perdoret pe saldimin e tubave apo rjetit hidraulik ne raste te ndryshme.
24	Vibrator ngjeshes	1	Kjo paisje do te perdoret per ngjeshjen e dherave te sistemuara, zhavorrit etj.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të cilat të përfshijnë objektin e prokurimit, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) -ose ekuivalent . *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose ekuivalent *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) - ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të Ligjit 162/2020 të Prokurimit Publik, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Konkretisht:

- **Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent**, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.
- synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj certifikate ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se OE ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

- **Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 45001:2018 ose ekuivalent,** është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta dhe janë shtjelluar në kriteret e mësipërme, si dhe në specifikimet teknike të projektit të zbatimit. Për këtë arsye, AK duhet të sigurohet se OE zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës.

Paisja me këtë lloj certifikimi dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

- **Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 ose ekuivalent**, na shërben pasi sikurse përcaktohet edhe në VNM e përgatitur nga projektuesi, zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga sa më sipër AK ka kërkuar që OE të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) për të dëshmuar kapacitetin për të kryer punimet në përputhje me rekomandimet e VNM, në konformitet me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standardet shtetërore dhe ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor.

2.4.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit/distributorit të autorizuar për zërat pjesë të punimeve “Materialet Hidraulike”. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë duke paraqitur akt-marreveshje/autorizim/kontrate lidhur me kompanisë prodhuese dhe distributorit të autorizuar.

- Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi, për të gjitha zërat e materialeve hidraulike objekt prokurimi në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion justifikues (certifikata/deklarata prodhuesi/flete analiza) për standartet dhe kërkesat që duhet të përmbushin zërat e kërkuara në formularin e specifikimeve teknike.

- **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë edhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit të cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet shërbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.